


BULETINI



TETOR 2023



Fuqizimi i të rinjve në komuna: Projekti M4Y



Në kuadër të projektit, u publikua një thirrje për propozime për grante të vogla që synon grupet joformale dhe OJQ-të, duke u fokusuar tek individët e moshës 15-24 vjeç në komunat e Graçanicës, Ranillugut, Fushë Kosovës, Skenderajit dhe Vushtrri. ACDC-së i është besuar administrimi i këtyre granteve.

Në një takim të fundit mes kryetares së Komunës së Ranillugut, Katarina Ristiç Iliq, dhe anëtarëve të OJQ ACDC, Dushan Radaković dhe Aleksandar Rapajić, diskutimet u fokusuan në projektet që mbështesin të rinjtë përmes iniciativës Komunitat për Rini (M4Y).

Projekti "Komunitat për Rini (M4Y)" është krijuar për të fuqizuar të rinjtë për të marrë pjesë plotësisht në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve socio-ekonomike lokale.

Aksioni i pastrimit në Mitrovicën Veriore



Në kuadër të angazhimit tonë për mbrojtjen e mjedisit, ACDC organizoi një ngjarje pastrimi të brigjeve të lumit. Vullnetarët u bashkuan për të hequr mbeturinat nga brigjet e lumit, duke kontribuar në ruajtjen e bukurisë natyrore të zonës dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kjo nismë nuk kishte për qëllim vetëm pastrimin e brigjeve të lumenjve, por edhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e mbrojtjes së lumenjve si burime thelbësore ujore dhe hapësira publike.



Sesion informues - Dhomat e Specializuara të Kosovës

Në bashkëpunim me Dhomat e Specializuara të Kosovës, OJQ ACDC organizoi një sesion informues në Qendrën e Energjisë Civile (CEC) në Graçanicë. Përfaqësuesit nga KSK-ja dhanë njohuri të hollësishme për mandatin dhe punën e tyre në lidhje me rastet e krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe veprave të tjera të rënda penale.

Iniciativat për të Drejtat e Njeriut

Duke vazhduar angazhimin tonë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ne kemi qenë aktivisht të angazhuar në iniciativa të ndryshme. Teksti i publikuar në tetor eksploron rëndësinë e lirive të shprehjes brenda Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke analizuar veçanërisht ndikimin e saj në Kosovë



Gjatë gjithë tetorit, fushata jonë për të promovuar të drejtat e njeriut vazhdoi, me një grup të ndryshëm që përhapi ndërgjegjësimin dhe avokoi për parimet e të drejtave të njeriut dhe demokracinë. Qëllimi është që të adresohen sfidat që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në Kosovë dhe të nxitet një mbrojtje dhe respektim më i madh i këtyre të drejtave brenda komunitetit.



Shërbimet e ndihmës juridike falas

Gjithashtu, në kuadër të përpjekjeve tona të vazhdueshme, ne publikuam informatat mbi shërbimet e ofruara nga Agjencia e Ndhmës Juridike Falas për të ngritur ndërgjegjësimin për ndihmën juridike të disponueshme në fusha të ndryshme.

Gjithashtu, ACDC në vazhdimësi ofron shërbime të ndihmës juridike falas duke mbështetur Zyrën për Ndhmë Juridike Falas në veri të Kosovës. Në këtë cilësi, OJQ ACDC fton të gjithë individët që përballen me vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre në Kosovë që të vizitojnë zyrën dhe të lidhen me bashkëpunëtorët juridikë të cilët do të ofrojnë shërbime juridike, informata dhe këshilla falas.



Vizitë nga "SMART Balkans"



Visita e fundit e ekipit të SMART Balkans në OJQ ACDC ishte e përqendruar në vlerësimin e përparimit të nismave tona, shqyrtimin e rezultateve të arritura dhe duke trajtuar sfidat me të cilat përballemi



Njoftim për projektin e ri

Jemi të emocionuar të shpallim projektin e ri të financuar nga UNMIK-u, projekt i fokusuar në avancimin e të drejtave të njeriut përmes rritjes së ndërgjegjësimit publik. Projekti synon të fuqizojë Forumin e Bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Kosovës (IAPK) dhe Shoqërisë Civile. Gjithashtu synon të zhvillojë formularët e ankesave në faqen e internetit të IAPK-së dhe të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e korigjimit. Gjithashtu, qëllimi i projektit është ngritja e vetëdijes së banorëve të komunave veriore për të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Fushata për Parandalimin e Vërshimeve dhe Zhvillimi i Planit Lokal

Në kuadër fushatës për parandalimin e vërshimeve të realizuar nga ACDC, është hartuar një Plan Lokal për Komunën e Mitrovicës së Veriut, që synon zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet dhe sigurimin e reagimit të duhur në situata emergjente. Ky plan është i disponueshëm në faqen tonë të internetit në të tri gjuhët.



Mundësitë e zhvillimit të aftësive për të rinjtë

Në kuadër të projektit të financuar nga GIZ, u hap një thirrje për pjesëmarrje në seminare dhe sesione trajnimi, duke u ofruar të rinjve një mundësi unike për të rritur aftësitë e tyre dhe për të marrë njohuri të vlefshme në fusha të ndryshme.

FOLLOW US

